



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.231/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NNP CTA shpk me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga drejtori Z.M., kundër të paditurit 1.Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E.P. dhe 2.Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.L., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe paditurit të dytë, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative K.A.nr.35/22 i datës 07.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar Ankesa e paditësit NNP CTA shpk me seli në Prishtinë, dhe ankesa e të paditurit të dytë Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative KA.nr.35/22 i datës 07.11.2023, PRISHET, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rivendosje dhe rigjykim

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar të Dhomës së shkallës së parë, është vendosur si në vijim: Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NNP CTA shpk me seli në Prishtinë, Anulohen vendimi PSH.nr.341/18 datës 13.08.2018 i nxjerr nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit si dhe Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 26.09.2018 dhe Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 13.08.2018 të nxjerra nga i padituri i dytë Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, II Refuzohet në tërsi kërkesëpadia e paditësit NNP CTA shpk, që të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Universiteti Haxhi Zeka, në mënyrë solidare ti kompensojnë dëmin në emër të fitimit të humbur në vlerë prej 93,266.55€, III Ky aktgjykim i zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues. V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, dhe pala e paditur Universiteti Haxhi Zeka në Pejë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, Arbër Fazliu avokat në Prishtinë, me ankesë e kundërshton aktgjykimin e ankimuar, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, të priset aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë dhe ti kthehet në rishqyrtim apo kërkesëpadia e paditësit të miratohet në tërsi si e bazuar dhe përveç anulimit të vendimit PSH.nr.341/18 dt.13.08.2018, të obligohen të paditurat të kompensojnë edhe fitimin e humbur në vlerën prej 92,266.55€.

Pala e paditur Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, përmes përfaqësuesit të autorizuar L.L., me ankesë e kundërshton aktgjykimin e ankimuar, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat të cilat janë dorzuar nga ana jonë, dhe duke mos i vlerësuar drejt këto prova ka nxjerr vendim jo të drejt, i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave të veproj në bazë të dispozitave ligjore dhe ta aprovoj ankesën e Universitetit Haxhi Zeka, si të bazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimin të kontestuar në drejtim të thënieve në ankesa, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se:

Ankesat janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Organi Shqyrtues i prokurimit (OSHP), me vendimin përfundimtar të nxjerr në procedurën administrative, nr.341/18 të datës 13.08.2018, ka aprovuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik NNP CTA në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ndërtimi i Fakultetit të arteve faza II” nr.prok.208/18/017/521 të iniciuar nga autoriteti kontraktues Universiteti Haxhi Zeka, ka Vërtetuar Njoftimin për dhënie të kontratës , lidhur me këtë aktivitet të prokurimit iniciuar nga AK Universiteti Haxhi Zeka.

Kundër këtij aktvendimi paditësi NNP CTA në Prishtinë, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë ndaj të paditurve OSHP-së dhe Universitetit Haxhi Zeka në Pejë, respektivisht ka kundërshtuar aktin administrativ përfundimtar të paditurit dhe Njoftimit për dhënie të kontratës nga A.K. Dhoma e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor të datës 23.10.2023, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin e ankimuar, e Aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se gjykata vlerëson se i padituri i dytë nuk ka vlerësuar drejt plotësimin e kushteve të tenderit nga OE i rekomanduar për kontratë, pasi që sipas ekspertizës së ekspertit të prokurimit B.P., OE Armendi-FA, kishte dorëzuar certifikatat e ISO standardeve, mirëpo të njëjtat nuk ishin të noterizuara, po ashtu mungojnë noterizimet e

diplomave të inxhinierëve dhe CV e tyre janë të panënshkruara, kërkesa këto që sipas ekspertit ishin mandatore dhe të njëjtat nuk ishin plotësuar. Gjykata në kuptim të nenit 9.2 të Rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, vlerëson se përkundër që të njëjtit kanë qenë të papërgjegjshëm, paditësi nuk ka shfrytëzuar mundësin ligjore që pranë AK të paraqes pretendime lidhur me këta OE. E paditura OSHP me të drejt nuk ka shqyrtuar pretendimet në ankesën e datës 12.07.2018 pasi që nuk kanë qenë pretendime të paraqitura fillimisht në kërkesën për rishqyrtim, andaj gjykata vlerëson se i padituri i parë nuk ka pasur obligim shqyrtimin e pretendimeve të reja që nuk janë paraqitur më parë pranë A.K. Gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e fitimit të humbur shumën prej 93,266.55€ pasi një kërkesë e tillë nuk ka mbështetje ligjore. Gjykata refuzoi kërkesën për kompensimin e dëmit duke iu referuar nenit 137 të LMD-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës edhe sipas pretendimeve ankimore të palëve ndërgjyqëse, gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe neni 183 i LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, se është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij, po ashtu jo i plotë lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike. Sipas Kolegjit, aktgjykimi i ankimuar, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, sipas nenit të theksuar më lartë, nga shkak se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar, është i pakuptueshëm apo kontradiktor dhe si i tillë është i paekzekutueshëm.

Kolegji vlerësoi, se aktgjykimi i ankimuar është i mangët në përmbledhjen e fakteve vendimtare sipas gjendjes faktike të çështjes, sepse Dhoma e shkallës së parë në procedurën e konfliktit administrativ, pasi ka nxjerr një gjendje faktike të re të vërtetuar përmes ekspertizës së prokurimit datës 20.07.2023 nga eksperti B.P., nuk ka ballafaquar të gjeturat e konstatimit të kësaj ekspertize të prokurimit, me ekspertizën e ekspertit shqyrtues të prokurimit (OSHP-së) në Raportin e datës 24.07.2018, e cila rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi paraprak i A.K. për dhënie të kontratës perkatësisht rekomandon që ankesa e operatorit ekonomik-paditësit NNP CTA shpk, të refuzohet si e pabazuar. Kolegji vlerëson se Dhoma e shkallës së parë, në rastet e tilla kur kemi kontradikta në akte, është nxjerr konkluzion jo i drejte në aspektin e gjendjes faktike gjatë procedimit administrativ, për ta vendos çështjen në mënyrë meritore është dashur të siguroj, vërtetoj dhe ballafaqoj të gjitha faktet që i ka vërtetuar e paditura OSHP-së, përmes ekspertit të saj shqyrtues të prokurimit, me provat e reja të siguruara në konflikt administrativ gjyqësor, ashtu që do të gjente zbatim dispozita e nenit 43 paragrafi 3 i LKA-së.

Prandaj Kolegji Dhomës së shkallës së dytë, duke vlersuar një gjendje të tillë, që vetëm në bazë të një ekspertize të prokurimit, të vendoset çështja kryesore lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimi “ Ndërtimi i Fakultetit të Arteve faza II” me nr.prokurimi 208/18/017/521 të inicuar nga autoriteti kontraktues-Universiteti Haxhi Zeka, duke i falur besimin ekspertizës së

prokurimit dt.20.07.2023, se asnjëri nga tenderuesit nuk ishte i përgjegjshëm në momentin e përfundimit të vlersimit nga ana e AK, tani për tani Kolegji nuk mund të pranoi si të drejtë aktgjykimin e atakuar.

Meqë nuk kemi një vërtetim të plotë të gjendjes faktike nga dhoma e shkallës së parë, duke mos vlersuar dhe ballafaquar dy ekspertizat e prokurimit të nxjerr në konflikt administrativ dhe ajo e nxjerr tek organi administrativ OSHP-së, Kolegji tani pranon pretendimet ankimore të paditësit dhe autoritetit kontraktues Haxhi Zeka, sepse si pasojë e anulimit në tërësi të aktivitetit të prokurimit sipas aktgjykimit të atakuar, mos vërtetimit në tërësi të gjendjes faktike, Kolegji e ka të pamundur të shqyrtoj pretendimet e të paditurit Haxhi Zeka, se e ka dorzuar dosjen komplet të tenderit ku vërehet se CV janë të nënshkruara nga stafi adekuat sipas kërkesave të tenderit. Sa i përket pretendimeve të paditësit lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur, Kolegji vleron se këto pretendime është dashur ti shqyrtoj dhoma e shkallës së parë në kuptim të dispozitës së nenit 46 paragrafi 5 i LKA-së, që parasheh: *me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.* Mirëpo në këtë rast dhoma e shkallës së parë, ka vendosur çështjen në mënyrë meritore, duke mos vërtetuar drejtë ligjshmërinë e vendimit kontestues të paditures OSHP-së, Njoftimin mbi vendimin e A.K., dhe Njoftimin për dhënien e kontratës të A.K. Kolegji vleron se në rastet e ekzistimit të kontradiktave të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, dhoma e shkallës së parë ka mund të zbatojë edhe nenin 43 par.2 të LKA-së.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vleroi gjithashtu se në kuptim të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, është kontradiktor dispozitivi i aktgjykimit ankimor me arsyetimin e tij, sepse me Arovimin e pjesërisht të kërkespadi së paditësit, në asnjë rast në arsyetim të aktgjykimit nuk jepen spjegime ligjore dhe faktike, lidhur me këtë dispozitiv të aktgjykimit me të cilin është aprovuar pjesërisht kërkespadi e paditësit NNP CTA shpk, nuk dihet se për cilën kërkesë të paditësit është aprovuar pjesërisht kërkespadi e paditësit, përderisa në dispozitiv të aktgjykimit Refuzohet si e pabazuar kërkespadi e paditësit.

Shkeljet e tilla respektivisht paqartësitë dhe kontradiktat si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në riprocedurë, Dhomat e Shkallës së parë, me rastin e rivendosjes dhe rigjykimit të kësaj çështje, të shqyrtoj në baza ligjore çështjen e zbatimit të drejtës materiale nga neni 43 i LKA-së,

ashtu që të siguroj dhe ballafaqoj të gjithë faktorët me rëndësi gjatë vendosjes në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të rekomanduar, sipas dosjes së tenderit, në aktivitetin e prokurimit publik të A.K., palët e interesuara, ekspertizën e ekspertit shqyrtues të prokurimit (OSHP-së), dhe varsisht nga sigurimi i gjendjes se vërtetuar faktike dhe bazës ligjore të merr aktgjykim të drejt dhe të ligjshëm nga neni 43 dhe 46 i LKA-së

Nga arsyet e lartë cekura aktgjykimi i ankimuar, priset dhe lënda i kthehet Dhomës së shkallës së parë në rigjykim.

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.231/24 datë 21.03.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha